



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:261308

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06374855

P.nr.575/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, në përbërje prej Gjyqtares së vetme gjykuese Benita Berisha, me bashkëpunëtorin profesional Visar Zeqiri, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit D. Q., nga fshati V. K. Lipjan, të cilin e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.5425/23, të datës 15.12.2023, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, me datën 26.09.2024, në prani të Prokurorit të shtetit Nebahate Salihu, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. Xhemajl Ademaj, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.10.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. Q., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin V. K.Lipjan ku dhe jeton, nga ati F., e ëma B., e vajzërisë M., me numër personal *numri...*, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Më datë 14.08.2023 rreth orës 18:00, i pandehuri D. Q. në fshatin V., komuna e Lipjanit, me dashje, më qëllim të dëmtimit trupore e ka sulmuar fizikisht me mjete të rrezikshme për shkaktimin e dëmtimeve trupore sikurse më mjet të metalit çelës të gomave të veturës të dëmtuarin E. Q., për shkak të mosmarrëveshjeve të më hershme, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari kishte qenë me veturën e tij duke dalë nga fshati V., në një kthesë ishte takuar me të pandehurin i cili ishte duke vozitur me një shpejtësi të madhe edhe ofendohen me fjalë, i dëmtuari vazhdon rrugën kurse i pandehuri e përcjellë ashtu që me të ndaluar tek pompa e derivateve në fshatin Q. për ta mbushur automjetin me derivate i kishte shkuar pas i pandehuri e kishte ndaluar veturën afër veturës së të dëmtuarit duke ia bllokuar rrugën, ka dalë jashtë veturës e ka marrë një mjet (çelës të gomave) dhe e kishte goditur disa herë në shpinë, në krahë dhe në këmbë, për çka i dëmtuari ka marrur trajtim mjekësorë, me ç'rast sipas ekspertizës mjeko ligjore i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

- Me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2. lidhur me par.1. pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, dhe nenit 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 365, 449, 452 dhe 462 të KPP-së, e:

G J Y K O N

- I. Me Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Në kuptim të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të akuzuarit, Dënimi me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i zëvendësohet me Dënim me Gjobë në shumë prej dymijë (2000) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 € (euro) gjobë me një (1) ditë burgim.
- IV. Konform nenit 276 par.1 të KPP-së, Konfiskohet në mënyrë të përhershme mjete i metaltë-çelësi i gomave, me të cilin është kryer vepra penale. Urdhërohet Policia e Kosovës që të bëjë shkatërrimin e tij pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- V. Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej njëzet (20) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej njëzet (20) euro, si dhe njëzet (20) euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.
- VI. Pala e dëmtuar E. Q. nga fshati V. K. Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP.II.nr.5425/23, të datës 15.12.2023, e ka akuzuar të pandehurin D. Q., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.09.2024, në të cilën kanë prezentuar Prokurori i shtetit Nebahate Salihu, i akuzuari D. Q. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av.Xhemajl Ademaj.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit, i akuzuari në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se, e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se është penduar për veprën penale të kryer, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, tani është martuar dhe po e pret një fëmijë, me familjen e të dëmtuarit sipas traditave janë pajtuar, e ka lutur gjykatën që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit Nebahate Salihu lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore në dispozitat e KPPK-së, i ka propozuar gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe të njëjtit ti shqiptoj një dënim konform dispozitave ligjore.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av.Xhemajl Ademaj, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se, pajtohet me të mbrojturin e tij i cili e pranoj fajësinë dhe njëherit deklaroi se një vepër të tillë nuk do ta përsërisë kurrë, luti për mirëkuptim pasi që i mbrojturi i tij ka krijuar familje dhe tash do të bëhet prind si dhe me palën e dëmtuar familjarisht janë pajtuar dhe nuk do të kenë hasmëri mes tyre dhe janë pajtuar dhe e luti gjykatën që duke u bazuar në ligj të shqiptoj një dënim të arsyeshëm me kusht apo vërejtje gjyqësore.

Gjyqtarja e vetme gjyqëse pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptur natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së, gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë së të akuzuarit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i akuzuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe nuk ka qenë më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, faktin se është penduar për veprën e kryer, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë më vepra të tilla, e rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa rrethana rënduese në rastin konkret nuk gjeti. Andaj, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë, gjykata e mori konform nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushallin gjyqësor dhe ekspertizën, u bazua në nenin 449 par.2 nën par 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën par 3.1 të Ligjit numër 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin lidhur me konfiskimin, gjykata e mori konform nenit 276 par.1 të KPPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike u bazua në nenin 462 par.1 dhe 2. të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal.
P.nr.575/23, me datën 22.10.2024.

Bashkëpunëtori Profesional
Visar Zeqiri

GJYQTARJA
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.